



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:136528
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05480861

C.nr.518/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me zyrtarin e lartë për bashkëpunim profesional Visar Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. K. nga fshati B. Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kryeziu avokat nga Malisheva, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson avokatura shtetërore av. Naim Krasniqi, me objekt të padisë “Kompensimi i shujtave”, vlera e kontestit 758.00 euro, jashtë seance me datë 20.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. **APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit M. K. dhe **DETYROHET** e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, që paditësit M. K. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit-shujtave ditore për ditët e pranisë në punë (për 379 ditë pune) dhe atë për periudhën kohore nga data 15.10.2020 e deri me datën 21.11.2022, t’ia paguaj nga dy euro për një ditë pune ose shumën e përgjithshme në vlerë prej **758.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë me datë 25.06.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro dhe atë, në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm, ndërsa REFUZOHET pjesa tjetër e kërkuar nga paditësi përtej kësaj shume.

Ar sy e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi M.K. nga fshati B./Malishevë, përmes të autorizuarit të tij Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, me datë 25.06.2021 në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARR) me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompensim i shujtave.

Sipas padisë dhe parashtrësës për precizimin e padisë, paditësi është në marrëdhënie pune në Qendrën e Kompetencës “K. K.” në Malishevë në pozitën e mësimdhënësit për më shumë se 10 vite dhe nga gjykata ka kërkuar që e paditura AAAPARR të obligohet që t’ia paguaj paditësit në emër të kompensimit për ushqimin-shujtën ditore për ditët e pranisë në punë, nga 2 euro për një ditë, duke llogaritur periudhën kohore nga data 15.10.2020 e deri me datën 21.11.2022 ose gjithsejtë 379 ditë pune. Duke u bazuar në provat që gjenden në lëndë dhe duke u bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive dhe të Ligjit të Punës, ka propozuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 758.00 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej datës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, për precizimin e kërkesëpadiisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes avokaturës shtetërore ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se paditësi si anëtar i sindikatës apo vet SBASHK-u nuk ka asnjë angazhim të vetëm apo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare, dhe se për realizimin e kësaj të drejte lidhur me ushqimin nuk ekzistojnë mundësitë financiare.

Ka shtuar se mbështetur në dispozitën e nenit 78 par.1 të ligjit nr.03/L-212 të punës, përcaktohet se i punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqes kërkesë te punëdhënësi për realizimin e të drejtave të shkelura, dhe sipas par. 2, punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin prej 15 ditëve nga data e pranimit të kërkesës, kurse, sipas nenit 79 të këtij ligji, çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin ose nuk merr përgjigje brenda afatit, në afatin vijues prej 30 ditëve mund të inicioj kontest pune në Gjykatë.

Ka theksuar se dispozitat ligjore nga LMD dhe neni 87 i ligjit nr.03/L-212 i punës, përcakton qartë institutin e parashkrimit ku të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, e që rrjedhimisht periudha e kërkuar për kompensim është mbi 3 vite dhe se kontrata kolektive e arsimit është

lidhur për një periudhë tre vjeçare, konform nenit 90 të ligjit të Punës, e që konstatohet se nuk është më në fuqi.

Po ashtu ka theksuar se lidhur me aprovimin e shujtës, e paditura vlerëson se nuk është detyrim me të cilën do të detyrohej të paguaj shujtën, paditësit i mungon baza ligjore për realizimin e të drejtës sipas kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit.

Në fund gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave ta hedhë si të palejuar padinë e paditësit, ose me aktgjykim të refuzohet si e pabazuar padia.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat dhe vlerësimi i tyre

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Kontratën e punës nr.... të datës 07.12.2016 e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, Vërtetimi për ditët e punës nr. prot.... i datës 29.02.2024 i lëshuar nga Qendra e Kompetencës “K. K.” në Malishevë së dhe Vërtetimi mbi marrëdhënien e punës nr. prot.... i datës 30.04.2021 i lëshuar po ashtu nga Qendra e Kompetencës “K. K.” në Malishevë.

Nga provat e bashkangjitura padisë, gjykata gjeti se paditësi M.K. është në marrëdhënie pune tek e paditura përkatësisht mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës “K. K.” në Malishevë që nga data 01.09.2010 dhe ende vazhdon të punoj. Ky fakt provohet përmes vërtetimit mbi marrëdhënien e punës nr. prot.... të datës 30.04.2021 dhe gjithashtu vërtetohet edhe me kontratën e punës të lidhur mes paditësit dhe të paditurës me datë 07.12.2016 me nr.

Nga vërtetimi nr.1592/4 i datës 29.02.24 i lëshuar nga Qendra e Kompetencës “K. K.” në Malishevë, vërtetohet se paditësi gjatë periudhës kohore nga data 15.10.2020 e deri me datën 21.11.2022 ka realizuar gjithsejtë 379 ditë pune.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura gjatë kësaj periudhe për të cilën edhe e ka kërkuar kompensimin fakt ky i vërtetuar me kontratën e punës nr.319/3 dhe vërtetimin nr.1655/3. Po ashtu nuk ishin kontestuese as ditët e pranisë në punë të paditësit, këto të vërtetuara edhe nga vërtetimi për ditët e punës nr.1592/4, të cilave gjykata ua fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1 të LPK-së, në të cilin përcaktohet se: “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti

publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, andaj pasi vërtetimet-dokumentet janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, gjykata ua fali besimin e plotë.

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse pala e paditur ka legjitimitet në këtë çështje kontestimore dhe nëse kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar. Pra në këtë procedurë për gjykatën ishte e rëndësishme që ta vërtetoj bazën ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe besueshmërinë e saj me prova e po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se ajo nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë dhe se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar.

Pasi kompensimi për shujta kërkohet për periudhën kohore nga 15.10.2020 e deri me datë 21.11.2022, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të cilat kanë hyrë në fuqi me datat 18.04.2017 dhe 22.01.2021 dhe me këto Kontrata parashihen të drejtat e punëtorëve të arsimit për kompensim në emër të ushqimit dhe kompensime tjera.

Sipas Mendimit Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.... të datë 27.02.2023, në Pikën e IV të këtij mendimi juridik parashikohet se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovës e datës 18.04.2017 aplikohet për periudhën prej 18.04.2017 deri më 21.01.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021 aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022 kur edhe është shkëputur nga MASHT.

Konform dispozitave të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021 dhe 22.01.2021 të lidhura mes Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, në nenin 35 paragrafi 7 përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”,* andaj duke u nisur nga kjo, gjykata vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtat ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë, përkatësisht për periudhën 15.10.2020 deri më 21.11.2021, pra për 379 ditë pune të llogaritura nga dy (2) euro për një ditë pune (379 ditë pune x 2 euro = 758 euro).

Detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është e përcaktuar edhe me nenin 8.1 të Ligjit nr 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”,* kurse me nenin 245 të LMD-së është paraparë që: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”,* e që në këtë rast e paditura është e detyruar që të përmbushë një detyrim ndaj paditësit.

Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ku me nenin 3 paragrafin 2 përcaktohet se: *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin e shujtave u vendos që të njëjtën ta aprovoj.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, por pretendimet e tilla i ka konsideruar si të pabazuara, ngase paditësi padinë e ka parashtruar në periudhën në të cilën ishin në fuqi Kontratata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi e ka parashtruar padinë në periudhën që përkon me kontratën kolektive të vitit 2017 dhe 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, pra padinë e ka parashtruar me datë 25.06.2021, kurse periudha kohore e kërkesës është nga data 15.10.2020 dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave, neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcakton se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, por pretendimet e tilla i konsideroi si të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontratata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me dispozitat e par.1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020, paditësit i'a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë më 25.06.2021 e deri në pagesën definitive.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”* dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t'ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 125.00 euro dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumen prej 104.00 euro dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore, ndërsa pjesa tjetër ose shuma prej 104.00 euro e kërkuar në emër të shpenzimeve për precizimin e kërkesëpadisë është refuzuar dhe këto shpenzime nuk i'a ka njohur gjykata, sepse me parashtrësën për precizim, paditësi vetëm kishte saktësuar periudhën kohore për të cilën ka kërkuar kompensimin, prandaj nuk mund të detyrohet pala e paditur për shpenzime të cilat janë krijuar me fajin e vet paditëses, për arsye se këtë saktësim/precizim ka mundur ta bëjë edhe me padi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.518/21, datë 20.03.2024

G j y q t a r i

Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.